Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 15.07.2022 me anë të cilit Agjencia shpallet jokompetente sa i përket kërkesës së palës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga Komuna e Podujevës. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115) Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala i ka nuk i plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës nga AKP pasi që subjekti juridik Komuna e Podujevës nuk është NSH dhe nuk bie nën jurisdikcionin administrativ të Agjencisë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022



Nazmi Mikullovi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-167/38

Në bazë të neneve 5.12 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 Korrik nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Raporti Përmbledhës i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-ve, i datës 08 korrik 2022 lidhur me asetet:

KPS1533/PRN202, OP "Automakedonija" me seli ne Shkup, asetet në Prishtinë, bie nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;

- I. Çdo aset tjetër eventual i kësaj ndërmarrjeve që do të identifikohet në të ardhmen nga AKP, të njëjtat bien nën juridiksionin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Përcaktimin e Statusit të Entiteteve (KPS), ku pas shqyrtimit të lëndës për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjes/Aseteve të OP "Automakedonija" Shkup, asetet në Prishtinë KPS1533/PRN202, ka konstatuar se asetet e ndërmarrjeve të lartcekura janë pronë shoqërore, dhe bien nën kompetencë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në.

Në përputhje me nenet 5, 6 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115) Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022



Nazmi Mikullövci
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-167/39

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 04/L-088 për arkivat shtetërore, 19 mars 2012; Ligjin nr. 04/L-184 për administrimin e punës në zyrë, 28 maj 2013; Rregulloren (MAP) nr. 01/2015 për Shenjat unike të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre; Rregulloren (MAP) nr. 05/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (MAP) nr. 01/2015 për Shenjat unike të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre si dhe Rregulloren e Likuidimit nr. 4-2020 për politikën dhe procedurat e likuidimit AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 Korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Rregullorja për Rregullimin e lëndës arkivore, digjitalizimin dhe dorëzimin në Arkivin kompetent për Ndërmarrjet Shoqërore në Likuidim.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Menaxhmenti për aprovimin e Rregullores së lartcekur.

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Rregullorja për "Rregullimin e Lëndës Arkivore, digjitalizimin dhe dorëzimin në Arkivin kompetent për Ndërmarrjet Shoqërore në Likuidim" do të mundësojë që përmes rregullimit dhe asgjësimit të materialit të pavlefshëm, digjitalizimit të lëndës së vlefshme arkivore, të lirohen objektet të cilat janë përdor për arkiva, si dhe qasje në dokumentacionin digjital të NSH-ve.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022.



Nazmi Mikullovci
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-168/40

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores për qiradhënie të aseteve të N.Sh-ve të aprovuar me 30 janar 2019, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohen rekomandimet e menaxhmentit të rezultateve të qiradhënies përmes shpalljes publike të datës 22.06.2022, sipas listës së bashkangjitur në këtë vendim.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin për qiradhënie publike të gjithsej 30 (tridhjetë) aseteve të Ndërmarrjeve shoqërore në likuidim, ku prej tyre: 10 asete janë rekomanduar nga menaxhmenti për aprovim; 7 asete janë rekomanduar për refuzim nga menaxhmenti dhe 13 asete janë pa oferta. Rekomandimet për refuzim Menaxhmenti janë për shkak të çmimit të ultë të ofertës për m², dhe krahasimit me kontratat aktuale të qirasë në lokacione të afërta.

Qiradhënia e aseteve do të vazhdonte të rriste vlerën e fondeve të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore, fonde këto që do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës për të mira publike, si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Ndërsa refuzimi i aseteve dhe ri-shpallja e tenderëve për këto asete, do të rriste konkurrueshmërinë dhe mund të arrihen çmime më të larta që do mundësonin të ardhura të vazhdueshme dhe të sigurta dhe eliminonin nevojën e sigurimit të pronës dhe monitorimit të shpeshtë nga uzurpimet e mundshme prej personave të papërgjegjshëm. Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022.



Nazmi Mikullovci
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Lista e Aseteve për qiradhënie të Aseteve të NSH-ve në Likuidim përmes shpalljes publike

Nr	Rajoni	Emri i NSH-së-njësia	Emri i Ofertuesit me ofertën më të lartë	Udhojt i asetit	Vendndodhja e Asetit dhe Komuna	Nr i vendimit të DM mbli të komisionit për qira	Sa herë është dhënë me qira?	Chini më i lartë i qiradhënies paraqitur ose Tenderimit të fundit	Spërfaqja m ² krahësive të lartës të objektit/depo	Chini për krahësive për m ² të bazës të ofertes më të lartës të pranuar e në Raportet e Verifikimit	Chini i Ofertes më të lartës të lartës	Numri i Ofertave	Vendimi i Bordit	A ka të angazhuar momentalisht sigurim për asetet PO/JO
1	Gjilan	NSH "Zarije Buljqi"	N/A	Toka dhe Objektit në Pasajë	fshati Pasajë, komuna Partesh	DM388/2022	0	0	9,532 m ² tokë (1,503.95 m ² objekt)			0	N/A	PO
2	Gjilan	NBIQ "Agromerava"	N/A	Objekti dhe depo	fshati Verbovc, komuna Klokot	DM390/2022	0	119	468 m ² tokë (170 m ² objekt/depo)			0	N/A	JO
3	Gjilan	MZT FAM	N/A	Objekti punues	Viti, komuna Viti	DM391/2022	0	380	2,500 m ²			0	N/A	PO
4	Gjilan	NewCo XIM Strezovci	N/A	Një pjesë e objektit administrativ	fshati Bervojcë, komuna Kamenicë	DM392/2022	0	0	200 m ²			0	N/A	PO
5	Gjilan	NewCo XIM Strezovci	N/A	Një pjesë e objektit administrativ	fshati Bervojcë, komuna Kamenicë	DM392/2022	0	0	119 m ²			0	N/A	PO
6	Pejë	NT Koreniku - Nj.1 Dytani nr.2	N/A	Dytan	Istog	DM388a/2022						0	N/A	JO
7	Pejë	NSH Virxhinia - Nj.2 Depot në katën perdhese	Kreshnik Sheremeti	Depo	Gjakovë	DM388a/2022	1	€ 350.00	300m ² €	0.59	€ 0.66	2	Refuzim	PO
8	Pejë	NSH Virxhinia - Nj.3 Kati II	Fisnik Spahija	Hapësirë zyrash	Gjakovë	DM388a/2022	N/A	N/A	1150m ² €	0.59	€ 0.025	1	Refuzim	PO
9	Pejë	NT Koreniku - Nj.4 Dytani nr.3	N/A	Dytan	Istog	DM388a/2022						0	N/A	JO
10	Pejë	NT Koreniku - Nj.5 Restorant Koreniku	N/A	Dytan	Istog	DM388a/2022						0	N/A	JO
11	Pejë	NSH Fabrika e Bujës "Produkt" - Nj.6	N/A	Dytan	Barje e Pejës, Istog	DM384a/2022	1		75m ²			0	N/A	JO
12	Pejë	NSH Stacioni Veterinues - Istog - Nj.7	Ernal Berisha	Objekt	Gurakoc	DM387a/2022	1	€ 30.00	70m ² €	2.82	€ 2.85	1	Aprovim	JO
13	Pejë	NT Agrodukagjini - Nj.8	N/A	Depo	Pejë	DM387a/2022						0	N/A	JO
14	Pejë	NSH Bokset e Kosoves - Nderresa administrative - Nj. 9	N/A	Objekt	Klinë	DM385a/2022						0	N/A	PO
15	Pejë	NSH Bokset e Kosoves - Separatori - Nj.10	Artan Dautaj- Atlas N Sh.p.k.	Separacion	Volljake, Klinë	DM385a/2022	1	€ 4,000.00	Malineria		N/A	5	Refuzim	PO
16	Pejë	NSH Tregjet - Lokali nr.6 - Nj.11	Filireta Berisha	Dytan	Pejë	DM386a/2022	2	€ 100.00	24m ² €	3.17	€ 4.38	1	Aprovim	JO

[Signature]



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Lista e Aseteve për qiradhinë të Aseteve të NSH-ve në Likuidim përmas shpalljes publike

Nr	Rajoni	Emri / NSH-së-njësia	Emri / Ofertuesit me ofertën në të lartë	Udhi / Asetit	Vendndodhja e Asetit dhe komuna	Nr i vendimit të DM mbledhjes themelimit e komisionit për qira	Sa herë është dhënë me qira?	Çmimi në i lartë i qiradhinës përpraktike ose Tenderimit të lundit	Sipërfaqja m ² krahësues me të lartë të pranuar e raportit të lundit	Çmimi për m ² krahësues me të lartë të pranuar e raportit të lundit	Çmimi i Ofertës në të lartë	Numbri i Ofertave	Vendi i Bërit	A la të angazhuar monedhësigurim për asetin - PQ/JO
17	Peja	NSH "Tregjet - Lokali nr.5 - N.12	Shkurtë Shala	Dyqan	Peja	DM3864/2022	2	€ 85.00	36m ²	€ 3.05	€ 110.00	1	Aprovim	JO
18	Prishtina	Urtara	N/A	Zyre	Rr. Smionda, p.n. Grahçiq	DM395-2022			40x170			0	N/A	JO
19	Prishtina	Jugopetrol	N/A	Depo	Afer Fabrikës së vajit në Ferizaj	DM395-2022			8,090			0	N/A	JO
20	Prishtina	Bankkos	Pajtim Berdha	Bankkos Shtëpi	P.K. 7232, ZK Prishtina, Rr. Bill Clinton	DM395/2022	1	€ 5,111.00	267.78	€ 2.50	€ 7.05	1,888.00 Euro	Refuzim	JO
21	Prishtina	NSH Përparimi	Faton Sylejmani	Objekt Afarist	P.K. 7232, ZK Prishtina, Rr. Bill Clinton	DM397/2022	N/A	N/A	93	€ 2.50	€ 0.37	€ 250.00	Aprovim	JO
22	Prishtina	NSH Përparimi	Faton Sylejmani	Depo	P.K. 7230, ZK Prishtina, Rr. Bill Clinton	DM397/2022	N/A	N/A	634	€ 2.50	€ 0.23	€ 2,750.00	Aprovim	JO
23	Prishtina	NewCo Grand Hotel - Zyra nr.301	Iliridon Beuthegi	Zyre	Zyra në katë e tretë në Objektivin e Grand Hotel-it, Shteti Zahir Pajaziti Prishtinë	DM394/2022	2	€ 180.00	23.25	€ 11.11	€ 4.52	€ 105.00	Refuzim	JO
24	Prishtina	NewCo Grand Hotel - Zyra nr.302	Iliridon Beuthegi	Zyre	Zyra në katë e tretë në Objektivin e Grand Hotel-it, Shteti Zahir Pajaziti Prishtinë	DM394/2022	0	€ 70.00	23.25	€ 11.11	€ 4.73	€ 110.00	Refuzim	JO
25	Prishtina	NewCo Grand Hotel - Zyra nr.305	Kushtrim Ellica	Zyre	Zyra në katë e tretë në Objektivin e Grand Hotel-it, Shteti Zahir Pajaziti Prishtinë	DM394/2022	1	€ 240.00	23.25	€ 11.11	€ 10.45	€ 243.00	Aprovim	JO
26	Prishtina	NewCo Grand Hotel - Depo afër Bazarit të re	Ekrem Krasniqi	Depo	Depo gjendë afër DISCO SUI, në Objektivin e Grand Hotel-it, Shteti Zahir Pajaziti Prishtinë	DM394/2022	0	€ 0.00	21.6	€ 8.13	€ 12.18	€ 479.00	Aprovim	JO
27	Prishtina	NewCo Grand Hotel - Kuzhina Kysore	Ekrem Krasniqi	Kuzhinë	Kuzhina gjendë afër Bazarit të re, Grand, Shteti Zahir Pajaziti Prishtinë	DM394/2022	0	€ 0.00	330	€ 8.13	€ 8.45	€ 2,789.00	Aprovim	JO
28	Prishtina	NewCo Grand Hotel - Dikotela e vjetër	Ekrem Krasniqi	Dikotela	Dikotela gjendë afër Bazarit të re, Grand, Shteti Zahir Pajaziti Prishtinë	DM394/2022	0	€ 0.00	460	€ 8.13	€ 6.28	€ 2,889.00	Refuzim	JO
29	Prizren	"RQ241 NTH "Lina" Prizren- Lokali nr.1 në ndërtesën "Supermarketi" Bashkëdhënë	Blerina Elhami	Loka afarist	Rr. Adem ashar-Bashkëdhënë, Prizren	DM396-2022	2	€ 250.00	30	€ 3.57	€ 8.67	€ 260	Aprovim	JO
30	Prizren	"RQ241 NTH "Lina" Prizren- Lokali nr.4 në ndërtesën "Supermarketi" Bashkëdhënë	Bardha Bojashi	Loka afarist	Rr. Adem ashar-Bashkëdhënë, Prizren	DM396-2022	2	€ 70.00	15	€ 3.57	€ 10.00	€ 150	Aprovim	JO



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-167/41

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores për qiradhënie të aseteve të N.Sh-ve të aprovuar me 30 janar 2019, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet qiradhënia me tender publik i aseteve të NSH Metaliku Gjakovë bazuar në listën e bashkangjitur për qiradhënie.
- II. Anulohet qiradhënia për asetin e NSH Metaliku Gjakovë me tender publik: parkingu/oborri përballë objektit halla e ndërtuar për zhvillim. Aseti në fjalë të ri tenderohet pas matjeve në terren.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin për qiradhënie publike të gjithsej për tetë (8) asete. Sipas raportit të komisionit i cili ka pranuar ofertat të gjithë operatorët ekonomik i kanë plotësuar kushtet formale të tenderit publik dhe komisioni ka vlerësuar se për njësit 2 deri në 8 të shpallura me tender publik të aprovohet qiradhënia e aseteve kurse për njësinë numër 1 parkingu-oborri përballë objektit halla e ndërtuar për zhvillim në sipërfaqe prej 14939m² për shkak të lëshimit ku është bërë matja e tërë oborrit pa qasjen në rrugë të këtij reparti të anulohen ofertat për këtë njësi, të bëhen matjet në terren nga njësia e kadastrit dhe të tenderohet oborri pa pjesën e rrugës e cila i mundëson qasje në fabrike operatorit ekonomik.

Qiradhënia e aseteve do të vazhdonte të rriste vlerën e fondeve të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore, fonde këto që do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës për të mira publike, si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Ndërsa refuzimi i aseteve dhe ri-shpallja e tenderëve për këto asete, do të rriste konkureshmërinë dhe mund të arrihen çmime më të larta që do mundësonin të ardhura të vazhdueshme dhe të sigurta dhe eliminonin nevojën e sigurimit të pronës dhe monitorimit të shpeshtë nga uzurpimet e mundshme prej personave të papërgjegjshëm. Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashirojnë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022.



Nazmi Mikullovci
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Lista e aseteteve të qirasë për NSH "Metaliku" Gjakovë për tu aprovuar nga BD të AKP-së

Nr	Regjon	AKP ID	Emri i NSH-së	Pershkrimi i Asetit/Prones	Sipërfaqja	Vendodhja e Asetit/Prones	Qirararresi	Data e fillimit të qirasë	Data e përfundimit të qirasë	Shuma mujore e qirasë/ Euro	Pagësimi i llogarit të NSH/AKP	Verejtje
1	Pejë	PEJ080	Metaliku	Halla e prodhimit të Kordit	6209 m ²	Gjakovë	Rroni Fer	01.08.2022	31.07.2022	1,722.00 €	NSH	Kontrate për shfrytëzimin e asetit të Ndërmarrjes
2	Pejë	PEJ080	Metaliku	Halla e prodhimit të Tëlit	8411 m ²	Gjakovë	Rroni Fer	01.08.2022	31.07.2022	1,909.00 €	NSH	Kontrate për shfrytëzimin e asetit të Ndërmarrjes
3	Pejë	PEJ080	Metaliku	Objekti i kalldajës - Objekti perçjellës i rezervareve të mazutit	767m ²	Gjakovë	Rroni Fer	01.08.2022	31.07.2022	618.00 €	NSH	Kontrate për shfrytëzimin e asetit të Ndërmarrjes
4	Pejë	PEJ080	Metaliku	Rezervuarët e mazutit 2 cope	114m ³	Gjakovë	Rroni Fer	01.08.2022	31.07.2022	132.00 €	NSH	Kontrate për shfrytëzimin e asetit të Ndërmarrjes
5	Pejë	PEJ080	Metaliku	Rezervuarët e gazit 6 cope	150m ³	Gjakovë	Alfa Minerals & Alloys LLC	01.08.2022	31.07.2022	708.00 €	NSH	Kontrate për shfrytëzimin e asetit të Ndërmarrjes
6	Pejë	PEJ080	Metaliku	Objekti i halla e transportit	583m ²	Gjakovë	Rroni Fer	01.08.2022	31.07.2022	864.00 €	NSH	Kontrate për shfrytëzimin e asetit të Ndërmarrjes
7	Pejë	PEJ080	Metaliku	Objekti i ish ambulantës	269m ²	Gjakovë	Rroni Fer	01.08.2022	31.07.2022	492.00 €	NSH	Kontrate për shfrytëzimin e asetit të Ndërmarrjes



Listat e asetit qirasë për NSH "Metaliku" Gjakovë për anulim nga BD të AKP-së

Nr	Region	AKP ID	Emri NSH-së	Pershkrimi i Asetit/Prones	Sipërfaqja	Vendodhja e Asetit/Prones	Qirararësi	Pagësa ne llogaritë NSH/AKP	Vërejtje
1	Pejë	PE080	Metaliku	Parkingu/Oborri përballë objektit halla e ndërtuar për zhvillim	14939 m ²	Gjakovë	Anular-ritenderim	NSH	Kontratë për shfrytëzimin e asetit të Ndërmarrjes

[Signature]



Nr. Ref. BD-167/42

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 2.5 të kontratës bazë nr.ref. 1210/19, nenit 127 të LMD-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa që qiradhënia për pompën e benzinës në pronësi të NSH Jugopetrol, e cila ndodhet në ngastrën me nr. 02484/3 ZK Viti, të kaloj në emër të "IP-KOS" sh.p.k. me qëllim të shfrytëzimit me qira konform kushteve të parapara në kontratën standarde të qirasë përpiluar nga AKP.
- II. Cilësia e qiramarrësit nga Hekuran Aliaj tek "IP-KOS" sh.p.k., nuk mund të ndryshohet pa u shlyer borxhi në tërësi. Pasi të shlyhet borxhi në tërësi, të nënshkruhet kontrata me IP-KOS shpk.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit i ka paraqitur Bordit shqyrtimin e propozimit për transfer të qirasë nga z. Hekuran Aliaj si pronar i firmës "HA Petrol" sh.p.k. tek "IP-KOS" sh.p.k për asetën e NSH Jugopetrol.

Z. Hekuran Aliaj si pronar i firmës "HA Petrol" sh.p.k. është nënshkruar i Kontratës së qirasë në mes të AKP/AL NSH "Jugopetrol" në cilësinë e qiradhënësit dhe "Hekuran Aliaj" në cilësinë e qiramarrësit. Aneks kontrata e qirasë me nr.35666/2021 të datës 25.02.2021, skadon me datë 28.02.2023. Z. Hekuran Aliaj ka kërkuar që kjo kontratë të kalojë në emër të qiramarrësit tjetër përkatësisht "IP-KOS" sh.p.k, meqenëse aksionet e HA Petrol me pronar Hekuran Aliaj janë blerë nga "IP-KOS" sh.p.k. si pasojë e detyrimeve të akumuluar.

Duke pasur parasysh specifikat e asetit dhe vet procesit të likuidimit të NSH-ve, konkretisht për NSH Jugopetrol" dhe inkasimin e kësaj qiraje për rritjen e fondeve për kreditorët e NSH-së, është rekomanduar nga Autoriteti i Likuidimit që të të bëhet ky transfer. Kjo qiradhënie, do të vazhdojë të rriste vlerën e fondeve të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore, fonde këto që do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës për të mira publike, si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtojnë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022



Nazmi Nikullovci
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-167/43

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 18, 19 dhe 28 i Shtojcës së po të njëjtit Ligj, nenit 2.5 të kontratës bazë nr.ref. nr. 39897/2022, neni 6 paragrafi 4 dhe Neni 7 paragrafi 7 të Ligjit Nr.08/L-18 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet rekomandimi i Autoritetit të Likuidimit për NSH OTHPB Derivatet e Naftës Prishtinë "INA" Trgovina që kontrata e qirasë nr. 39897/2022 të ndryshohet respektivisht neni 1 paragrafi 2 i kontratës të ketë kohëzgjatje prej 6 vitesh nga data 15.03.2022 deri me 14.03.2028.
- II. Udhëzohet Menaxhmenti që në koordinim me departamentin ligjor dhe Autoritetin e Likuidimit të shtoj një nen apo klauzolë përmes së cilës AKP nuk do të mbahet përgjegjëse në rast të transformimit pronësor nga AKP apo bartjen e kësaj prone te Fondi Sovran apo institucionet pasardhëse të AKP-së vendosin që kontrata të ndërpritet para afatit 6 (gjashtë) vjeçar;
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit i ka paraqitur Bordit shqyrtimin e propozimit të qiramarrësit IP-KOS që periudha e shfrytëzimit të Deponisë së derivateve të naftës në Bardhosh e cila evidentohet në pronësi të NSH OTHPB Derivatet e Naftës "INA" (PRN149) Prishtinë, të zgjatet nga 2 (dy) në 6 (gjashtë) vjet shkaku i i ndryshimit të Ligjit Nr.08/L-18 Për tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme.

Qiramarrësi nuk ka mundur të operoj me deponinë e derivateve me shumicë për shkak se nuk është pajisur me licencë për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të Ripërtërishme me shumicë për shkak se kontrata e qirasë është për 2 vite, ndërsa me Ligjin Nr.08/L-18 Për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të Ripërtërishme, konkretisht Neni 6 paragrafi 4 Leja (licenca) jepet për 6 vite, dhe Neni 7 paragrafi 7 i cili përcakton që subjekti ekonomik të ketë deponinë në pronësi të vet, ose ta marr me qira nga pronari për kohëzgjatjen e lejes.

Prandaj, duke marrë parasysh situatën e krijuar me Ligjin e ri Për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme nevojitej që kontrata e qirasë me IP-KOS për shfrytëzimin e Deponisë së derivateve të naftës në Bardhosh, të ndryshoj përkatësisht neni 1 paragrafi 2 kohëzgjatja e qirasë të jetë 6 vite apo nga data 15.03.2002 deri me 14.03.2028.

Duke pasur parasysh specifikat e asetit dhe vet procesit të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, konkretisht për NSH "INA" dhe inkasimin e kësaj qiraje për rritjen e fondeve për kreditorët e NSH-së, është

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

rekomanduar nga Autoriteti i Likuidimit që të të bëhet ky ndryshim. Kjo qiradhënie, do të vazhdonte të rriste vlerën e fondeve të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore, fonde këto që do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës për të mira publike, si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022



Nazmi Mijkullovci
Kryesues
Bordi i Drejtoreve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-167/44

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 Korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprobimet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët NSH "Auto Prishtina" PRN126 (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DHPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmblidhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të Likuidimit të PRN126 NSH "Auto Prishtina" (Në Likuidim). Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022



Nazmi Mikullovci
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-167/45

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 Korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të pjesshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh "Dukagjini IMN" PEJ065 (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe poashtu shqyrtimit të analizave përmblledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të pjesshme të fondeve të Likuidimit të PEJ065 NSh "Dukagjini IMN" (Në Likuidim). Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022



Nazmi Mikullovci
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-167/46

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 Korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët NSH "Vet Station – Gjilan/Gnjilane 1" GJI145 (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DHPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të Likuidimit të GJI145 NSH "Vet Station – Gjilan/Gnjilane 1". Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022



Nazmi Mikullovci
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-167/47

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 Korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Anulohet vendimi Nr. Ref. BD-166/57 i Bordit të Drejtorëve të datës 04.07.2022 për aprovimin e Raportit të shpërndarjes së përkohshme të pjesshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh "19 Qershori IMN" PRN028.
- II. Aprovohet Raporti Korrigjues i Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh 19 Qershori IMN, PRN028 (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për NSh "19 Qershori IMN" PRN028 për përmbushjen e kërkesave të pranuar.

Në raportin i cili korrigjohet kishte ndodhur një lëshim teknik sepse në shumën totale të aprovuar ishte shuma gabim për arsye se tek njëri prej kreditorëve në listë, saktësisht tek kreditori me numër 43 në raportin e kaluar të shpërndarjes ishte bërë një lëshim teknik dhe ishte shumëfishuar shuma për këtë kreditor. Si pasojë, edhe raporti i shpërndarjes ishte paraqitur si i pjesshëm dhe pas rregullimeve të bëra ky Raport Korrigjues paraqitet si Raport i Shpërndarjes së Përkohshme. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022



Nazmi Mikullovi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-167/48

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 Korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen përfundimtare të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSH "Ljuboten – Brick Factory" GJI158 (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe vërtetimit se nuk ekziston ndonjë ankesë në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbljedhëse të të hyrave dhe shpenzimeve si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen përfundimtare të fondeve të Likuidimit të GJI158 NSH "Ljuboten – Brick Factory" (Në Likuidim). Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022



Nazmi Mikullovi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-167/49

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, nenit 42 të Ligjit nr. 03/154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 04/2020 për Politikën dhe procedurat e likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aset nr. P-71813061-00242-2 ZK Novakë me sipërfaqe prej 1606 m², dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aset.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42, par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ngastrat kadastra nr. 00242-2 me sipërfaqe prej 1606 m², është rast për heqje dorë për faktin se kjo pronë në bazë të gjendjes faktike në terren shfrytëzohet për varrezë.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aset nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës dhe në të njëjtën kohë nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv për arsye se ky aset shfrytëzohet si varrezë, e cila i shërben interesit publik të komunitetit të caktuar.

Pas aprovimit të kësaj kërkesë të Autoritetit të Likuidimit nga ana e Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, atëherë në përputhje me dispozitat e Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, pronësinë në atë paluajtshmëri e fiton subjekti publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Prishtinë, më 28 korrik 2022.



Nazmi Mikullovci
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-167/50

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 2.5 të kontratës bazë nr.ref. 27693/17, nenit 127 të LMD-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e parcelave që gjenden në ZK Ferizaj me nr. P-72217092-00525/0, 527/0, 0535/0, 0536/0, 0537/0, 0538/0, 0539/0, 0539/0, 0540/0, 0541/1, 0542/0, 0544/0, 3135/1, 3135/2 dhe 3135/3 me sipërfaqe 158772 m², objekt i Kontratës së Qirasë nga Bajram Kamberi tek Gëzim Kamberi, me qira vjetore në lartësinë prej 350.00 EUR neto.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit i ka paraqitur Bordit shqyrtimin e propozimit për transferimin e Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin tokës bujqësore në sipërfaqe prej 158772 m² nga Bajram Kamberi në cilësinë e tij si transferues tek djali Gëzim Kamberi.

Më 23.05.2022, Autoriteti i Likuidimit kishte pranuar një kërkesë me shkrim nga djali i qiramarrësit z. Gëzim Kamberi, në të cilën kërkohej ndërrimi i shfrytëzuesit aktual të Kontratës së Qirasë 27693/17-Out për arsye se qiramarrësi z. Bajram Kamberi ka ndërruar jetë dhe kontrata e qirasë të bartet në emër z. Gëzim Kamberi, në cilësinë e pranuesit.

Transferimi i Kontratës së Qirasë Vjetore për shfrytëzimin e parcelave të përshkruara si më poshtë është aprovuar me qëllim të rritjes së të ardhurave për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), fonde këto që do të mbahen për t'iu ndarë kreditorëve dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës për të mira publike, si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të paraqesin padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022



Nazmi Mikullovc
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-167/51

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 2.5 të kontratës bazë nr.ref. 14228/2018, nenit 127 të LMD-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 korrik 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i kontratës së qirasë për shfrytëzimin e lokalit OTEKS 2/3 në Mitrovicë të Veriut, sipërfaqe prej 43m² nga Jovan Nedeljković te Aleksandar Nedeljković me qiranë mujore në lartësinë prej 105.00 EUR.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

A R S Y E T I M

Autoriteti i Likuidimit i ka paraqitur Bordit shqyrtimin e propozimit për transferimin e Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e lokalit nga Jovan Nedeljković te Aleksandar Nedeljković.

Më 14.06.2022, Zyra Rajonale e Mitrovicës ka pranuar shkresën me nr. Prot: 4992/2022, nga personi privat Aleksandar (Jovan) Nedeljković i cili kërkon që t'i transferohet kontrata e qirasë me numër protokoll 14223/2018 të datës fillestare 11.07.2018 nga Jovan Nedeljković, në emër të Aleksandar Nedeljković (djali), kjo për arsye se qiramarrësi Jovan Nedeljkovic ka probleme shëndetësore. Parashtruesi i kërkesës është i gatshëm të vazhdojë qiramarrjen dhe paguaj qiranë me rregull njësoj siç kishte vepruar babai i tij.

Transferimi i Kontratës së Qirasë Vjetore për shfrytëzimin e lokalit në fjalë është aprovuar me qëllim të rritjes së të ardhurave për Ndërmarrjen Shogërore (NSH), fonde këto që do të mbahen për t'iu ndarë kreditorëve dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës për të mira publike, si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët. Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojnë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 Korrik 2022



Nazmi Mikullovci
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës